



---

**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 20.07.2017**

**“Për hapjen e programit të përbashkët të studimit “*Master i Shkencave*” në  
“*Shkenca Politike: Integrim dhe Qeverisje*”**

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 7; neni 38, gërma “dh”; neni 80, pika 1, 2, 3, 4 e 5; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19, pika 1; neni 20, si dhe në kërkesën e Fakultetit të Shkencave Sociale me shkresë Nr.253/1 Prot., datë 18.05.2017, në mbledhjen e datës 20.07.2017 Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të studimit “*Master i Shkencave*” në “*Shkenca Politike - Integrim dhe Qeverisje*” (*The Joint Master’s Programme Political Science- Integration and Governance (PoSIG)*), pranë Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale.
2. Gjuha e zhvillimit të programit: *Gjuha Angleze*
3. Një kopje e këtij Vendimi shoqëruar me dokumentacionin përkatës, t’i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vijimin e procedurave në lidhje me miratimin e programit të përbashkët të studimit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF.DR. MYNYR KONI**